



Planuar / Dorezuar Planned / Delivered	03.02.2023	viti year	2023
Organ / Njësia Org / Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojt e Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOK	1396	2023	116



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1122/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1122/2022 të datës 08.12.2022 e parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Zyra e Rregullatorit për Energji, në çështjen juridike "Kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 03.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1122/2022 e datës 08.12.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet Përgjigja me Nr. 486/22 e datës 25.10.2022 e Njesisë së Administratës së Përgjithshme Zyrës së Rregullatorit për Energji dhe konkursi ne Nr. Referencës RN00009877 i datës 16.09.2022 për pozitën Analist për Energji Termike, në Zyrën e Rregullatorit për Energji.
- III. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Zyrën e Rregullatorit për Energji, që të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, me qëllim të zbatimit të këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## Ar sy et im

Zyra e Rregullatorit për Energji, më datë 16.09.2022 ka njoftuar për shpalljen e Konkursit me Nr. Reference: RN00009877 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës "Analist për energji termike", në kuadër të kategorisë profesionale 1, ku afati për aplikim ka qenë nga datë 01.10.2022 deri me datës 10.10.2022. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo Njësia e Administratës të Përgjithshme në Zyrë e Rregullatorit për Energji, me datë 17.10.2022 ka nxjerr Njoftim me numër protokollit 452/22 për Verifikim paraprak të kandidatëve, ku ankuesi nuk është kandidat që ka kaluar verifikimin paraprak ndërsa përmes një dokumenti pa datë pa protokoll dhe pa nënshkrim shkruan që Aplikacioni është refuzuar.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Zyrën e Rregullatorit për Energji, ndërsa Njësia e Administratës së Përgjithshme përmes Përgjigjes me Nr. 486/22 të datës 25.10.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar me numër protokollit 486/2022, duke lënë në fuqi verifikimin paraprak të kandidatëve të datës 17.10.2022.

Ankuesi më datë 08.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7786/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 16.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Zyra e Rregullatorit për Energji, ndërsa kjo e fundit me datë 22.12.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 8289/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës me provat shtese përmes e-mailit zyrtar të datës 18.01.2023.

Me datë 19.01.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin VK/2023 me numër protokollit 519/2023, me të cilin i vazhduar afati i ankesës për dhjetë ditë pune.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova:* Ankesën me numër të protokollit 7786/2022 e datës 08.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes postes elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net, me datën 08.12.2022; Përgjigje e datës 25.10.2022 Nr.protokollit 486/22, nga Njësia e Administratës Përgjithshme, sipas ankesës së ankuesit; Konkursi i datës 16.09.2022 i shpallur nga Zyra e Rregullatorit për Energji; Përgjigje në ankesë e datës 22.12.2022 me Nr.protokollit 8289/2022; Provat shtese përmes e-mailit zyrtar të datës 18.01.2023 nga Zyra e Rregullatorit për Energji; Përshkrimi i detyrave të punës i datës 23.08.2022, lidhur me qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës; Vendimi i datës 23.06.2016 nga Bordi të ZRRE-së; Skema e pagave ZRRE-së; Vendim i datës 19.05.2016 nga ZRRE-së për strukturën organizative; Kopje strukturën organizative ZRRE-së; Aplikacioni i kandidatit S.B; Aplikacioni i kandidatit B.J; Aplikacioni i kandidatit B.B; Aplikacioni i ankuesit; Lista e ngushtë e nxjerrë nga sistemi SIMBNJ-së; Verifikimi paraprak i datës

17.10.2022 nr. Protokolli 452/22; Prova nga aplikacioni i refuzuar përmes sistemit SIMBNJ-së për S.B; Prova nga aplikacioni i refuzuar përmes sistemit SIMBNJ-së për B.S; Prova nga aplikacioni i refuzuar përmes sistemit SIMBNJ-së për Vendimi i datës 29.07.2022 për Komisionin e pranimit LVBK; Kontratë pune e datës 11.01.2019 me nr. protokolli 043/19 për A.S; Kontratë pune e datës 11.01.2019 me nr. protokolli 023/19 për P.K; Kontratë pune e datës 11.01.2019 me nr. protokolli 025/19 për Y.R; Kontratë pune e datës 11.01.2019 me nr. protokolli 050/19 për M.G; Kontratë pune e datës 11.01.2019 me nr. protokolli 037/19 për A.B; Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 02.11.2022; Njoftimi përmes sistemit SIMBNJ-së për verifikim paraprak për ankuesin, dhe shkresa zyrtare lidhur me refuzimin e aplikacionit; Verifikimi paraprak i datë 17.10.2022 nr.452/22; E-mail i datës 07.11.2022 nga Njësia e Administratës Përgjithshme, për B.J, për B.B.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuara, sepse:**

Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se në bazë të konkursit me Nr. Reference RN00009877 të datës 16.09.2022 të shpallur nga Zyrën e Rregullatorit për Energji lidhur me lëvizjen brenda kategorisë për pozitën "*Analist për energji termike*", me kritere të përgjithshme formale, kanë qenë si në vijim: *Arsimi i kërkuar: Diplomë/a e studimeve Universitare në Inxhinieri Mekanike, Elektrike ose Ekonomii; Së paku tri(3)vite përvojë pune në sektorin e energjisë apo të ngjashme e preferuar është përvoja në sektorin e energjisë termike(ngrohje qendrore)dhe apo të kombinuar me energjinë.* Ndërsa nuk ka pasur kërkesa të posaçme formale.

Kolegji i Këshillit, konstaton se në kohën kur është shpallur konkursit me Nr. Reference RN00009877 për pozitën "*Analist për energji termike*", ka qenë në fuqi Rregullorja (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, e cila ka përcaktuar edhe kategoritë e pozitive respektivisht kategorinë profesionale me klasat e saja nga profesional 1 deri në profesional 4, si rrjedhojë e kësaj pozita *Analist për energji termike*, sipas konkursit të lartcekur është kategorizuar në kategorinë profesionale 1, ndërsa sipas Rregullores (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, konkretisht tek shtojca Nr.1/8, të kësaj rregulloreje, janë përcaktuar kriteret lidhur me fushën e kërkuar të arsimit për klasën profesionale 1, siç parashihet: "*a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e Diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor). b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, Licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitën e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*", andaj meqë pozita në të cilën ka aplikuar ankuesi është e kategorisë profesionale 1, atëherë edhe konkursi është dashur të shpallet në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ndërsa në rastin konkret konkursi është shpallur në kundërshtim me dispozitat e lartcekura.

Kolegji i Këshillit, lidhur me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, ju referuar dispozitave të nenit 38 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: "1.

Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni. Në procedurën e lëvizjes brenda kategorisë për kategorinë profesionale mund të aplikojnë vetëm nëpunësit e kësaj kategorie, të konfirmuar sipas nënparagrafit 4.1 të nenit 37 të këtij ligji”, ndërsa lidhur me verifikimin paraprak Kolegji i Këshillit, ju referua Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, respektivisht nenit 44 paragrafi 1 dhe 2, i cili përcakton se: “1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje”, ndërsa sipas nenit 45 paragrafi 1, 2, 5 dhe 6, është përcaktuar se: “1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 5.Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimit të aplikimeve. 6.Brenda shtatë (7) ditëve nga data e njoftimit individual, në përputhje me paragrafin 5 të këtij neni, kandidatët e njoftuar që nuk plotësojnë kushtet e aplikimit, kanë të drejtë të paraqesin ankesë të brendshme. Ankesa parashtrohet më shkrim pranë NJBNJ. Ankesa shqyrtohet nga NJBNJ dhe vendimi njoftohet brenda shtatë (7) ditëve nga paraqitja e saj”, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, vlerëson se në bazë të provave të lëndës, Njësia e Administratës së Përgjithshme si Njësi Përgjegjëse për Burime Njerëzore nuk ka nxjerr Vendim lidhur me verifikimin paraprak për kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e konkursit, respektivisht duke mos dhënë edhe udhëzimin për mjetin juridik (ankesë) për ankuesin, me ç’rast janë shkelur dispozitat e lartcekura të ndërlidhura me nenin 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse në rastin konkret të ankuesit në provave të lëndës kjo është bërë përmes një dokumenti pa datë pa protokollin dhe pa nënshkrim vetëm i titulluar Aplikacioni është refuzuar pa dhënë arsye konkrete dhe të qarta lidhur me këtë çështje.

Bazuar në provat e lëndës, Kolegji i Këshillit, ka konstatuar se Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji më datë 29.07.2022 ka nxjerr Vendim për themelimin e Komisionit për Lëvizje brenda kategorisë për pozitën Analistë për Energji Termike dhe Gaz, ndërsa gjatë shqyrtimit të këtij vendimi, konstatohet se i njëjti nuk përmban pozitat e anëtarëve të këtij komisioni po ashtu nuk janë përcaktuar anëtarët zëvendësues siç parashikohet me nenin 46 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: “1.Çdo institucion themelon Komisionin e vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë (në tekstin e mëtejme “KVLBK”). 2.KVLBK përbëhet nga: 2.1. dy (2) anëtar nëpunës civil të specializuar në fushën përkatëse për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. dy (2) anëtar, nëpunës civil të nivelit më të lartë se pozita e lirë që rekrutohet për lëvizjen brenda kategorisë të institucionit përkatës ose institucionit tjetër të shërbimit civil, njëri nga ta mbikëqyrës i Drejtpërdrejte; 2.3. një (1) përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 3.KVLBK themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit, me propozim të NJBNJ. Për secilin anëtar, caktohen një anëtar kryesor dhe një anëtar zëvendësues. Anëtari zëvendësues ushtron detyrën në rastin e pamundësisë të përkohshme të anëtarit kryesor. Në rast të

*pamundësisë së pjesëmarrjes të Mbikqyrësi i Drejtpërdrejtë, ai zëvendësohet nga një nëpunës tjetër i të njëjtës kategori me të".* Po ashtu referuar këtij vendimi, Kolegji konstaton se në pikën II thuhet: *"Komisioni për Lëvizje brenda kategorisë sipas këtij vendimi obligohet të zhvillojë verifikimin paraprak dhe vlerësimin e kandidatëve",* ndërsa sipas dispozitave ligjore në fuqi konkretisht të nenit 45 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, verifikimi paraprak kryhet nga Njësia e Burimeve Njerëzore, kështu që kjo pikë bie në kundërshtim me frymën e normës, sepse Komisioni për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë ka obligim të bëjë vetëm vlerësimin e kandidatëve sipas nenit 47 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Lidhur me Përgjigjen me Nr. 486/22 e datës 25.10.2022 e Njesisë së Administratës së Përgjithshme Zyrës së Rregullatorit për Energji, Kolegji i Këshillit, konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e shqyrtimit të ankesës në procedurën e verifikimit paraprak nxjerr Vendim në pajtim me paragrafin 6 të nenit 45 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit, bazuar në provat e lëndës ka gjetur se në bazë të renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 02.11.2022 dhe emailit zyrtar të sistemit elektronik SIMBNJ-së të datës 07.11.2022, kjo procedurë ka përfunduar pa kandidat fitues, sepse dy nga kandidatët që kanë kaluar verifikimin paraprak sipas njoftimit të datës 17.10.2022, nuk kanë arritur që asnjë nga kandidatët që të vlerësohen me gjashtëdhjetë 60 pikë të përgjithshme, mirëpo meqë janë konstatuar shkelje procedurale në këtë procedurë duke filluar nga kushtet e përgjithshme formale dhe të tjera si të evidentuara në këtë vendim, atëherë Kolegji i Këshillit konstaton se nuk është konsumuar në mënyrë të drejtë procedura e lëvizjes brenda kategorisë për pozitën e lartcekur, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit bazuar në të gjeturat dhe konstatimet e pasqyruara si më lartë thekson faktin se Zyra e Rregullatorit për Energji obligohet që të zhvilloj procedure të re të rekrutimit "Lëvizje brenda kategorisë" për pozitën e punës *Analist për energji termike*, pasi që Kolegji ka konstatuar se për shkak të metave ligjore në aspektin e përcaktimit të kriterëve të përgjithshme formale në konkursin e kontestuar në këtë ankesë vlerësohet se nuk janë konsumuar veprimet formale nga neni 38 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë ku përcaktohet se: *"Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë"*, respektivisht Kolegji i Këshillit vlerëson se pa u përsëritur apo rishpallur konkursi për lëvizje brenda kategorisë, institucioni nuk mundet të vazhdoj tutje me procedurat e tjera të parashikuara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publikë.


Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.


**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1122/2022.

**Avdyll BEKTESHI**

  
Procesmbajtës

**Malsore GASHI BAJRAKTARI**

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Zyrën e Rregullatorit për Energji; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

